



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 01.02.2012, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyqi, Duda Balje, Justina Pula, Biserka Kostiq dhe Kymete Bajraktari.

Pjesëmarrës të tjerë: Koalicioni i Pensionistëve të Kosovës, Sabri Kadriu, Hamdi Tasholli, Sahit Dragaj dhe Fahri Buqinca; Lejla Selimi - OSBE, Visar Bivolaku- EUSR, Ervin Ibrahim - UNDP, Ramadan Ademi dhe Bahtir Istrefi- SPKT, Ukë Gashi – ZPRK dhe Nuredin Ibishi - këshilltar i kryetares së Komisionit nga CDF- ja.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi: Suazan Novoberdali, kryetare. Ajo konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtur më 12 dhe 18 janar 2012;
3. Shqyrtimi peticionit të koalicionit të pensionistëve të Kosovës;
4. Shqyrtimi kërkesës së KMLDNJ;
5. Miratimi i Raportit të punës njëvjeçare të Komisionit për vitin 2011;
6. Caktimi i raportuesve lidhur me shqyrtimin e projektligjit për personat e verbër;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtur më 12 dhe 18 janar 2012

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 12 dhe 18 janarit 2011.

3. Shqyrtimi peticionit të koalicionit të pensionistëve të Kosovës,

Kryetarja- Tha se e kemi marruar peticionin dhe seancën e kemi njoftuar me peticion dhe se kjo çështje është e ndjeshme. Në seancën e kaluar projektligji për skemat pensionale, të financuara nga shteti, është kthyer në ripunim për shkak të pakënaqësive që i keni pasur.

Naser Avdiu- Tha se ne e kemi të nënshkruar këtë peticion nga pesë subjekte dhe se Kuvendi i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar, e ka kthyer në Qeveri këtë projektligj për rishqyrtim.

Me tutje shtoi se delegacioni i koalicionit të peticionit, i përbërë prej pesë subjekteve ishim dy herë te kryeparlamentari i Kuvendit të Kosovës. Pastaj ishim te Presidentja e Kosovës, te shefi i Zyrës Civile Ndërkombëtare, ishim edhe te zëvendësambasadori i Britanisë së Madhe. Ai i njoftoi të pranishmit me vizitat që i ka pasur me institucionet shtetërore dhe vendet e kvintit të përfaqësuara në Kosovë.

Në fund Komisionit u ofron edhe një dokument, ku kishte paraqitur kërkesat e pensionistëve me gjerësisht.

Kurtan Kajtazi- Duke u ndërlidhur me peticionin e koalicionit të pensionistëve të Kosovës tha se sa i përket projektligjit, Kuvendi e ka kthyer prapë në Qeveri. Ne nuk jemi kompetent që të merremi me atë projektligj. Prandaj mandati i Komisionit është ta shqyrtojmë peticionin, një kërkesë e juaja ka qenë që të mos miratohet ligji në Kuvend dhe mundësia për një debat parlamentar në seancë.

Rita Hajzeraj- Ne, si Komision, mundemi përmes këtij peticioni ta sensibilizojmë opinionin. Ne, si shtet, nuk kemi shumë pensionistë, sepse te ne dominon rinia dhe konsideroj se kemi ende mundësi që të ofrojmë zgjidhje për këtë kategori të popullatës. Ligji edhe pse është kthyer, ne do bëjmë presion në Qeveri që ligji të sillet sa më shpejt me ndryshime, por nuk besojmë se ai projektligj të jetë krejt në rregull. Komisioni do të ketë mundësi që të punojë dhe ta përmirësojë. Ne do mundohemi ta gjejmë rrugën sa më të lehtë për realizimin e kërkesave tuaja deri në atë masë sa ju të ndaheni të kënaqur. Qeveria do të përgjigjet me ato mundësit buxhetore që i ka.

Albana Gashi- Tha se mirë është bërë që është kthyer projektligji në Qeveri, sepse ka qenë diskriminues. Kërkesat që janë në peticion janë shumë të arsyeshme dhe ne, si lëvizje vazhdojmë t'i përkrahim, sidomos kur bëhet fjalë për pagat. Ne mendojmë që fillimisht të gjithë pensionistet të marrin një pagë minimale. Mandej të bëhet edhe përshkallëzimi duke llogaritur edhe kontribute, dhënie; është më mirë të pritët ndoshta edhe një vit, sesa të bëhet një ligj jo funksional.

Kymete Bajraktari- Duke u ndërlidhur me petitionin tha se mbas gjashtë muajve projektligji ka mundësi të procedohet prapë në Kuvend. Ne po presim dhe nuk mundemi t'i përballojmë mashttrimet, kërkesat tuaja janë plotësisht të arsyeshme dhe pajtohemi me to.

Justina Pula- Tha se çështja e pensionisteve është një problem prekës. Ne, si Komision, do t'i gjejmë të gjitha mënyrat për t'ju ndihmuar. Mirëpo jemi vetëm një mekanizëm i Kuvendit për t'i shtyrë proceset përpara. Ne do mundohemi që edhe përmes debatit me qenë në anën e pensionisteve dhe t'ju përkrahim.

Sabri Kadriu- Tha se si është e mundur që brenda rajonit një koleg i imi që punon këtu me pension serb merr 550 euro, ndërsa unë marr 35 euro! Ne fazën e parë e kemi ndërmarrë në atë mënyrë që do të shkojmë me metoda profesionale. Faza tjetër do jetë; ne që jemi këtu, plus pesëdhjetëmijë të tjerë do organizojmë protestë. Nëse kjo nuk jep zgjidhje kemi rrugë të tjera që të vijmë deri te zgjidhja; Kombet e Bashkuara me Gjenevën, me Bashkësinë Evropiane, hapin e tretë do ta ndërmarrim me Strasburgun. Mirëpo jam i bindur se do bëjmë zgjidhje dhe s'do vijë deri te kjo. Shpresoj se do gjendet zgjidhja.

Kimete Bytyqi- bëri pyetje se a ju keni drejtuar ndonjëherë ndonjë ministrie te veçantë për ndonjë subvencionim si është ministria e transportit, financave apo shëndetësisë,

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv që e zhvilloi Komisioni lidhur me kërkesat e pensionistëve unanimisht vendosi që të nxjerrë këtë:

Rekomandim

1. Komisioni i rekomandon Kryesisë që në njërën nga seancat plenare të radhës, ta radhit si pikë të veçantë debatin lidhur me gjendjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Kosovës.
2. Komisioni i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i miratojë rekomandimet, si vijon:
 - Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në mënyrë urgjente të përgatisë pakon e projektligjeve lidhur me sistemin e pensionistëve dhe të invalidëve të punës.
 - Kërkohej ndryshimi dhe reformimi i skemës së pensioneve të menaxhuara nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale dhe nevoja e veçimit të personave që me vite kanë kontribuar në fondin e pensioneve të Kosovës.
 - Kërkohej nga Qeveria që pensioni mesatar të jetë 60% nga paga mesatare në Kosovë dhe çdo rritje ose zvogëlim i pensioneve të varet prej përqindjes së rritjes, apo zvogëlimit të pagës mesatare në Kosovë.
 - Kërkohej nga Qeveria që përderisa nuk sigurohen pensionet reale për ekzistencë, (jetë të denjë) për pensionistët të ketë subvencionime, për pagesën e rrymës, ujit,

- nxehjes, për transportin urban, barnat esenciale, kontrollet mjekësore, shërimin, pajisjet ortopedike etj.
- Kërkohej nga Qeveria, që gjatë takimeve dhe bisedimeve teknike me palën serbe, të vendosë me prioritet për zgjidhjen e çështjes, lidhur me fondin e pensionistëve të Kosovës.

4. Shqyrtimi i kërkesës së KMDLNJ

Kryetarja- I njoftoj me kërkesën e KMDLNJ për financimin e punës që bëhet. Ne kemi marrë nga ky këshill për të burgosurit, pra mendoj se janë partnerë të mirë për bashkëpunim dhe vlerësojmë të suksesshme punën e tyre, por lidhur me financimin le të vendos Kryesia e Kuvendit.

Komisioni lidhur me kërkesë e KMDLNJ nxjerr këtë:

Përfundim

Komisioni vlerëson Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë se është partner për bashkëpunim real dhe i suksesshëm në punën e tij.

I lihet në kompetencë Kryesisë së Kuvendit ta shqyrtojë dhe të vendosë se a do ta miratojë kërkesën për ndihmë materiale.

5. Miratimi i Raportit të punës njëvjeçare të Komisionit për vitin 2011

Kryetarja- Tha se kemi raportin e punës njëvjeçare të Komisionit për vitin 2011, ku janë përmbledhur aktivitetet e tij.

Albana Gashi- Tha se është gabim ku thuhet se kemi qenë panel intervistues në përzgjedhjen e kandidateve për zëvendës të Avokatit të Popullit. Ne kemi qenë panel për përzgjedhjen e dokumentacionit për zëvendësit e Avokatit të Popullit, dhe se nuk është në dijeni se është duke u bërë monitorimi i ligjit për barazi gjinore, sepse edhe ajo është pjesëtare e grupit punues.

Gjithashtu u kërkuar që aktivitete individuale të kryetares së Komisionit ta tërhiqen nga raporti.

Përfundim

Komisioni unanimisht miratoi me vërejtjet e dhëna Raportin e punës njëvjeçare të Komisionit për vitin 2011.

6. Caktimi i raportuesve lidhur me shqyrtimin e projektligjit për personat e verbër

Kryetarja- Tha se projektligji ka kaluar leximin e parë në Kuvend dhe ne jemi Komisioni Funkcional që duhet ta bëjmë shqyrtimin dhe amendamentimin e tij. Ne po formojmë një grup punues, i cili do ta punojë këtë projektligj dhe amendamentet që do t'i bëjë ky grup punues, do t'ia paraqesë Komisionit për shqyrtim dhe miratim.

Përfundim

Komisioni formoi grupin punues me këtë përbërje:

- 1.Suzan Novoberdali, kryetare,
- 2.Kymete Bajraktari , anëtare,
- 3.Kurtan Kajtazi, anëtar,
- 4.Albana Gashi, anëtare.

7. Të ndryshme

Kryetarja - Tha se me Raportin e Progresit dhe me Planin e punës së Komisionit kemi paraparë t'i bëjmë disa monitorime të ligjeve dhe do caktojmë grupet punuese lidhur me to.

Komisioni vendosi që të formojë disa grupe punuese për disa monitorime të ligjeve; Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Ligjin për personat e pagjetur. Lidhur me këto Komisioni vendosi të formojë grupet punuese me këtë përbërje:

1. Rita Hajzeraj, kryetare,
2. Albana Gashi, anëtare,
3. Kymete Bajraktari, anëtare,
4. Justina Pula, anëtare.

Ne monitorimin e ligjit për persona të pagjetur grupi punues formohet me këtë përbërje:

- 1.Albana Gashi, kryetare,
- 2.Suzan Novoberdali, anëtare,
- 3.Kurtan Kajtazi, anëtar,
4. Rita Hajzeraj, anëtare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu